



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opština/ Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit
Nr. 01-400-2203 Dt. 14/01/2020

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 81 të Ligjit 04/042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 61.4 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik të plotësuar dhe ndryshuar në prill 2018 dhe nenit 72.1 germa (k) të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 49 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohet **Adhurim Hoxha** për menaxhimin e kontratës me titull: “Shërbimet e varrimit për qytetarët e komunës së Drenasit për vitin 2019”, me numër të prokurimit: 611-19-195-225 të dt. 30.12.2019 dhe nr. arkivt: 02- 400-73476, që kryen: **Këshilli i Bashkësisë Islame Dega në Drenas**, përfaqësuar nga: **Beqir Thaqi - Drejtor**. (më tutje “Kontraktues”)

II. Përgjegjësitë e menaxherit të kontratës në fjalë janë:

Të menaxhojë obligimet dhe detyrat e autoritetit kontraktues të specifikuar me kontratë;
Të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë, ndërsa funksionet e menaxherit të projektit janë obligimet e parapara me normat e nenit 55.20 me nënparagrafet duke filluar nga germa (a) deri tek ajo (k) të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, kurse për punën e tij i raporton Zyrtarit Kryesor Administrativ të Komunës – Kryetarit.

III. Me këtë Vendim do të njoftohen Zyra e Prokurimit, Menaxheri i projektit, Operatori Ekonomik dhe Zyra e Kryetarit.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë;
- Menaxheri i Projektit;
- Operatorit Ekonomik;
- Arkivit të Komunës së Drenasit;

